

Suhareka
PËRTEJ



A-SH-E

Rrënjët e forta, vizion i ri!



Vizioni ynë:

Ardian Shala e sheh Suharekën si qendrën më të fortë zhvillimore të rajonit – një qytet që do jetë në shërbim të shumë gjeneratave që po vijnë.

Me përkushtim të pakushtëzuar, ai sjell një vizion të ri dhe të guximshëm: Suhareka do të ndërtojë themele të forta mbi tri shtylla të palëkundura – arsim cilësor, shërbime publike dinjitoze dhe ekonomi që rritë mirëqenien e qytetarëve. Ky program nuk është një listë dëshirash, por një plan konkret për transformimin e qytetit. Çdo projekt, çdo intervenim, çdo prioritet është menduar për ta rikthyer qytetarin në qendër të vendimmarrjes dhe për ta kthyer Suharekën në shembull të qeverisjes që lulëzon, jo që arsyetohet. Vizioni i tij nuk ndalet vetëm te e sotmja – ai shtrihet në të ardhmen: një Suharekë me shkolla të gjalla, vendbanime të pastra, ekonomi të gjallëruar dhe një turizëm të pozicionuar si shtyllë kyçe për dekadën e ardhshme.

Me Ardian Shalën në krye, Suhareka nuk do të kërkojë më rastin – ajo do ta krijojë atë vetë.

#ASHE



Përmbajtja:

A-SH-E: Shtyllat tona, vizion për shumë gjenerata!	4
1. Arsimi	7
1.2 Kultura, Rinia, Sporti	22
1.3 Gratë	30
1.4 Turizmi	34
2. Shërbimet	42
2.1 Shëndetësia	45
2.2 Infrastruktura	49
2.3 Administrata	57
2.4 Mjedisi	62
2.5 Emergjencat	66
2.6 Mërgata	69
3. Ekonomia	72
3.1 Ekonomia, Buxheti dhe Financat	74
3.2 Planifikimi hapsinor	79
3.3 Bujqësia	84
Pse Ardian Shala?	90



A-SH-E: Shtyllat tona, vizion për shumë gjenerata!

Tri shtylla si themel i palëkundur për shumë gjenerata. Ardian Shala si garantues i një vizioni për Suharekën që e meriton më shumë.

Suhareka është qyteti i njerëzve të ndershëm dhe punëtorë, njerëz që e duan vendin e tyre, nuk kërkojnë shumë, por meritojnë më mirë. Dhe pikërisht për këtë, Suhareka ka nevojë të qeveriset nga dikush që i ngjan vetë qytetarëve të saj: i ndershëm, i përkushtuar, i guximshëm. Këtë herë ka vetëm një adresë, një emër që mishëron këtë besim – Ardian Shala. Kemi ndërtuar një vizion që mbështetet në tri shtylla të qëndrueshme – arsim, shërbime publike dhe ekonomi të drejtë – sepse aty fillon gjithçka që e bën jetën më të mirë.

Arsimi është rruga drejt mundësive, dhe ne nuk do të lejojmë më që të jetë në harresë. Shërbimet publike janë pasqyra e respektit të shtetit ndaj qytetarit, dhe ato nuk do të jenë më privilegj i të fortëve, por e drejtë e secilit. Ekonomia është motori që e mban komunën gjallë – do ta rindizim me plan, drejtësi dhe përfshirje.



Këto nuk janë premtime që fryhen para zgjedhjeve dhe harrohen pas tyre. Janë boshtet e një kontrate të ndershme me qytetarët. Dhe Ardian Shala nuk është emër që vjen me fjalë boshe, por me përvojë të provuar, besim të fituar dhe vullnet për ta çuar Suharekën përpara, me dinjitet dhe guxim.

Kultura, rinia dhe sporti janë vendosur në këtë shtyllë sepse edukimi nuk ndodh vetëm në banka shkollore. Kultura, rinia dhe sporti janë shtylla identitare, zhvillimore dhe komunitare për Suharekën. Në vizionin tonë, Suhareka bëhet një qendër e gjallë kulturore, një vatër që mbështet kreativitetin dhe një hapësirë ku rinia dhe sporti marrin frymë lirshëm në institucione funksionale, përfshirëse dhe moderne. Përmes këtyre fushave ndërtojmë komunitet dhe fuqizojmë qytetarinë aktive.

Zhvillimi i Suharekës nuk mund të jetë i plotë pa përfshirjen e grave në mënyrë të barabartë dhe të strukturuar. Ne besojmë se gratë nuk janë vetëm pjesë e komunitetit – janë faktor i pashmangshëm zhvillimi në çdo fushë: nga ekonomia te politika, nga bujqësia te arsimit. Fuqizimi i grave dhe avancimi i rolit të tyre nuk është thjesht çështje barazie, por një domosdoshmëri për ndërtimin e një komune gjithëpërfshirëse dhe funksionale.



Për ne, turizmi nuk është vetëm një katalizator ekonomik, por një mjet edukimi dhe rilidhjeje të gjeneratave me natyrën, historinë dhe të ardhmen. Njohja me trashëgiminë kulturore dhe natyrore është pjesë e formimit qytetar dhe ndjeshmërisë sociale. Ne synojmë ta kthejmë Suharekën në një qendër turistike rajonale me ndikim kulturor, social dhe ekonomik, përmes një vizioni 10-vjeçar që bashkon qytetin dhe bjeshkën në një identitet të ri zhvillimi.

Për të gjitha këto – arsimin formal, edukimin kulturor e qytetar, fuqizimin e rinisë dhe sportit, përfshirjen e grave dhe promovimin e turizmit si vlerë edukative – kemi planifikuar investime në vlerë rreth 10 milionë euro nga buxheti komunal dhe 10 milionë të tjera donatorë nga Partneriteti Publiko – Privat (PPP).

1. Arsimi

i lënë në harresë, i kthyer si pikënisje

Arsimin e kemi vendosur në themel të platformës sonë, sepse besojmë thellësisht se e ardhmja e një shoqërie ndërtohet mbi cilësinë e arsimit që ajo u ofron brezave të saj. Në Suharekë, ai ka nevojë për një rifillim serioz. Pavarësisht përmirësimeve të pjesshme ndër vite, sfidat mbetin evidente: rënia e numrit të nxënësve, cilësia e ulët e mësimdhënies, mungesa e infrastrukturës moderne dhe politizimi i shkollave kanë ndikuar drejtpërdrejt në nivelin e dijes, motivimin e mësimdhënësve dhe përfshirjen e komunitetit.

Ne besojmë se një shkollë nuk është vetëm një vend ku mësohet, por një hapësirë ku nxënësit zhvillohen si qytetarë të përgjegjshëm, kritikë dhe krijues. Prandaj, për të vlerësuar realisht cilësinë në arsim, nuk mjafton të shohim vetëm testet dhe notat –duhet të analizojmë gjithë procesin: nga kushtet në klasë, motivimi i mësimdhënësve, mbështetja për nxënësit me vështirësi, e deri te menaxhimi i shkollës dhe përfshirja e prindërve.



#ASHE

Fakti që arsimin e kemi shtyllë kryesor të programit dëshmon që ne jemi të përkushtuar për ta ngritur në nivel tjetër arsimin në komunën tonë. Lidhur me këtë përveq adresimeve në këtë platformë ne kemi edhe një plan të detajuar për arsimin i cili do të jetë pikënisje e një transformimi të vërtetë. Ne mendojmë që një shoqëri e arsimuar do të jetë më e përgatitur për të ofruar shërbime cilësore por edhe e angazhuar për ti ofruar komunës tonë një zhvillim edhe në aspektin ekonomik.

Në këtë program kemi përqafuar një qasje të re: përmirësim i kushteve fizike në shkolla, mësim tërëditor, investim në teknologji, avancim të planifikimit zhvillimor dhe mbështetje të vazhdueshme për mësimdhënësit. Me bashkëpunim të ngushtë me MASHTI-n, inspektoratet, organizatat partnere dhe vetë komunitetin, do të zbatojmë veprime konkrete që i japin fund arsimimit me gjysmëzemër dhe i japin arsimin vendin që meriton, në zemër të çdo politike publike.

Po aq sa klasat dhe librat, edukimi përfshin edhe fushat që ushqejnë mendjen dhe trupin përtej orës së mësimi. Kultura, rinia dhe sporti do të trajtohen si shtylla të zhvillimit social dhe identitetit qytetar. Ne do t'i japim jetë institucioneve kulturore, do të fuqizojmë pjesëmarrjen rinore dhe do të mbështesim sportin në çdo lagje e fshat -për një Suharekë ku të rinjtë nuk largohen nga mundësitë, por i krijojnë ato vetë.



#ASHE

Vizioni ynë

Ne synojmë një sistem arsimor gjithëpërfshirës, të drejtë dhe inovativ që garanton cilësi, siguri dhe mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit dhe mësuesit në Komunën e Suharekës. Shkollat nuk do të jenë vetëm institucione të mësimi, por hapësira të dashura, krijuese dhe tërheqëse për fëmijët, rininë dhe komunitetin në tërësi. Për realizimin e këtij vizioni, do të investohen rreth 6.3 milionë euro në ndërtimin e shkollës model, digjitalizimin e klasave, pajisjen e kabineteve shkencore dhe garantimin e sigurisë fizike në të gjitha institucionet arsimore.

Çfarë na shqetëson?

Arsimi në Komunën e Suharekës këto vitet e fundit është përcjell me shumë sfida dhe vështirësi të cilat nuk kanë lejuar një zhvillim të arsimit në parametrat e pranueshme. Një ndër shqetësimet më të mëdha është trendi i vazhdueshëm i rënies së numrit të nxënësve, i cili rrezikon vetë ekzistencën dhe funksionimin normal të disa shkollave, veçanërisht atyre në zonat më të largëta.

#Arsimi



#ASHE

Gjatë këtyre viteve kemi pasur mungesë të aktiviteteve nëpër shkollat tona për ngritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësinxënie. Politizim të tyre duke emëruar drejtor me funksione partiake e duke detyru drejtorët të jen pjesë e fushatave dhe angazhimeve politike të partisë në pushtet në kundërshtim të procedurave ligjore.

Këto vite kemi pas edhe vonesa në rekrutimin e mësimdhënësve si pasoj edhe humbje të mëdha të orëve mësimore.

Ambientet e brendshme e të jashtme nuk kanë pas ndonjë trajtim të veçantë e nuk ka pas ndonjë investim që këto ambiente shkollore t'i bënte të përshtatshme, kreative e të dashura për nxënësit. Vonesa të mëdha në ndërtimin e shkollave me theks të veçantë problemet me ndërtimin e shkollës në Vraniç dhe Samadraxhë.



#ASHE

Me fitoren e Lidhjes Demokratike të Kosovës në mandatin tonë katërvjeçarë 2026–2029 ne do të angazhohemi për krijimin e një perspektive zhvillimore në arsim duke transformuar shkollat tona dhe duke i kthyer ato në hapësira të dashura, kreative, konkurruese dhe të sigurta për nxënësit. Synimet tona kryesore gjatë mandatit tonë katërvjeçarë janë:

- Mësim tërëditor, fillimisht në 5 shkolla
- Infrastruktura shkollore
- Teknologjia në shkolla
- Ngritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- Siguria e nxënësve në shkolla
- Edukimi i fëmijëve me nevoja të veçanta
- Çerdhet dhe edukimi parafillor.
- Prindërit e nxënësit pjesë e vendimmarrjes në shkollë.
- Bursa për nxënës dhe student
- Shkëmbimi i përvojave me nx. nga diaspora

Mësimi tërëditor në 5 shkolla

Brenda mandatit tonë do të implementojmë mësimin tërëditor fillimisht në tri shkollat e qytetit dhe dy në zonat rurale. Përzgjedhja do të bëhet në bazë të analizës së kapaciteteve dhe nevojave. Ky model do të zhvillohet në bashkëpunim me MASHT-in dhe Komunën e Prishtinës, duke marrë praktikat më të mira të zbatuara. Mësimi tërëditor garanton përmirësim të cilësisë në arsim dhe krijon më shumë mundësi për prindërit që të angazhohen në punë.

Infrastruktura shkollore

Me urgjencë dhe në bashkëpunim me MASHT do të trajtojmë problematikat e ndërtimit të shkollave në Vraniç e Samadraxhë dhe do të angazhohemi çdo ditë që ndërtimi i tyre të përmbyllet në afat sa më të shpejt.

Gjithashtu gjatë mandatit tonë do të ndërtojmë disa shkolla të reja, anekse e palestra sportive dhe do të investojmë në shkollat ekzistuese për t'i kthyer shkollat tona në qendra edukative, kreative e të dashura për nxënës.

Brenda mandatit tonë katërvjeçar do të intervenohet në këto shkolla:

- Ndërtimi i shkollës 7 Marsi- Suharekë (Investitor: Komuna dhe MASHT-i) 3 milion euro. Kjo shkollë do të jetë unike në tërë Kosovën dhe për një kohë shumë të shkurtë do të jetë model për të gjitha shkollat tjera.

Shkollat në të cilat do të ndërtohen anekse janë:

- Shkolla “Flamuri i Arberit” në Reshtan (Aneks)
- Shkolla “Dëshmorët e Greikocit” Greikoc (Aneks)
- Shkolla “Drita” Gelancë (Aneks për krijimin e hapsirave për laboratore)
- Shkolla “Ismet Jashari-Kumanova” Javor (aneks që të organizohet mësimi në një ndërrim)



#ASHE

- Shkolla “Vëllezrit Frashëri” Bukosh (Aneks për krijimin e hapsirave për laboratore dhe tualete)
- Analizë dhe intervenim i menjëhershëm në nyjet sanitare për të gjitha shkollat
- Mirëmbajtja e shkollave (nxemjeve qendrore dhe dëmeve eventuale të shkaktuara) Investim 2 milion euro.
- Ndërtimi i Palestrës Sportive në SHFMU “Dëshmorët e Tivarit” Peqan (Investitor: Komuna dhe MASHT-i) Investim 300 mijë euro
- Investime në rrethojat e shkollave, këndet e lojrave dhe ambientin e jashtëm shkollor.
- Investim në poligonet sportive (vija, paisje, dysHEME etj. Investim 500 mijë euro.
- Intervenim shkollës në Reqan.

6.5 milion euro investime në total për infrastrukturën shkollore.

Teknologjia në shkolla

Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë kërkon edhe një riorganizim të shkollave për përdorimin e kësaj teknologjie për zhvillimi e arsimit. Brenda mandatit tonë ne synojmë që secila klasë të jetë e paisur me smart bord (tabela të menqura) si mjet që avancojnë procesin e mësimdhënies dhe ndihmon mësimdhënësit e nxënësit për arritjen e synimeve të tyre. Diku do të investohen rreth 500 mijë euro për jetësimin e këtij premtimi.

Gjithashtu do të investohet që secila shkollë të ketë kabinetin e informatikës funksional (furnizim me laptop, internet në secilën shkollë).

Brenda mandatit tonë synojmë që të përgatisim një platformë për secilën shkollë, ku do të vendosen notata, mungesat e nxënësve, e të dhëna tjera të rëndësishme për shkollën, me qasje nga prindërit etj.

Gjithashtu do të organizohen edhe trajnime të vazhdueshme për mësimdhënësit për përdorim të teknologjisë në arsim.

Ngritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies

Ne synojmë që nga viti në vit të kemi ngritje të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe për këtë kemi planifikuar një mori aktiviteteve përmes të cilave synojmë ngritjen e cilësisë në arsim.

- Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme për mësimdhënës
- Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve (sipas udhëzimeve administrative)
- Të gjitha shkollat të kthehen me një ndërrim
- Ngritja e disiplinës në shkollë
- Furnizimi dhe funksionalizimi i kabineteve në të gjitha shkollat
- Organizimi garave komunale të njohurive (testi)
- Shpërblime për mësimdhënës dhe nxënës fitues në garat komunale
- Funksionalizimi i Aktiveve Profesionale
- Ngritja e nivelit të bashkpunimit të DKA-së me shkollë
- Krijimi i rrjetit të bashkëpunimit mes shkollave, me qëllim të rritjes së cilësisë dhe shkëmbimit të përvojave
- Organizimi i aktiviteteve për ngritje të cilësisë dhe aktiviteteve jashtë kurrikulare nëpër të gjitha fushat kurrikulare. (teste, kuize, aktivitete kulturore, gjuhëtari i ri, fëmijët në skenë, garat e recituesëve, gara sportive etj).
- Hapja e profileve të reja sipas kërkesave të tregut për shkollat profesionale.



#ASHE

- Në bashkpunim me Shoqatën e biznesit do të riorganizojmë praktiken profesionale.
- Mbështetje të plotë për tri shkollat e mesme për ti kthyer ato në shkolla model në Kosovë.
- Mësimi plotësues dhe shtues për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore ose që mbeten mbrapa
- Ora e kujdestarisë dhe kujdestaria ditore
- Kampet verore-dimërore; aktivitete kreative dhe edukative jashtë vitit shkollor
- Roli i psikologut dhe pedagogut në shkollë (shërbimi profesional)
- Mësimi zgjedhor dhe zhvillimi i kompetencave qytetare.

Siguria e nxënësve në shkollë

- Në secilën shkollë do të themelojmë Këshillin e sigurisë për shkollën përkatëse.
- Kujdestaria ditore e mësimdhënësve do të monitorohet e zbatohet në përpikmëri.
- Të gjitha shkollat të paisen me kamera të sigurisë
- Funksionalizimi i të gjitha daljeve emergjente në të gjitha shkollat
- Funksionalizimi i hidranteve nëpër shkollë
- Funksionalizimi dhe mbikqyrja e aparateve për zjarrfikës
- Sigurim fizik për shkollat e mesme.

Edukimi i fëmijëve me nevoja të veçanta

Edukimi /arsimimi i nxënësve me nevoja të veçanta është ndër prioritetet tona , duke e pasur parasysh që rreth 10% e populates sipas OBSH-së janë me nevoja të veçanta e si te tillë edhe nxënës në shkollat tona kanë nevojë për mbështetje ne kemi menduar që tu ofrojmë përkrahjen e duhur të gjithë nxënësve.

Në shumë raste nxënësit nuk e marrin në kohë këtë shërbim i cili është i domosdoshëm dhe shumë i rëndësishëm për nxënësit me nevoja të veçanta, familjet e tyre dhe shoqërinë ,ne planifikojmë marrjen e hapave konkret në mënyrë që të ofrojmë atë që kërkohet në legjislacion.

Programi jonë parasheh që gjithëpërfshirja si concept i shkruar në ligjet e arsimit dhe në udhëzimet administrative duhet të jetësohet edhe në vepra konkrete.

Disa nga hapat që ne planifikojmë ti marrim për të përkrahur fëmijët e nxënësit do i shtjellojmë në vazhdim.

Krijimi i dhomave burimore (sipas nevojës - 3 deri 5 dhoma)

Dhomat do jenë qendra të cilat përdoren rreth organizimit të procesit mësimor për nxënësit në nevojë ,këto dhoma do i udhëheq mësuesi mbështetës etj.

Me dhomat burimore do të krijonim kushte të përshtatshme që lidhen me material didaktik specifik, hartimin e planeve individuale, rishikimet e vlerësimet, takimet me prindër ekipe profesionale, etj.

Punësimi i mësuesve mbështetës e asistentëve

Mësimdhënësit mbështetës profesional (pedagogët special)në shkolla e veçanërisht në atoku ka dhoma burimore do mundësojnë që të jenë urë lidhëse në mes të mësimdhënësve-prindërve-asistentëve dhe profesionistëve të tjerë brenda e jashtë shkolle.

Punësimet e asistentëve - asistentët e nxënësve duhet të punësohen në kohën sa më të shpejt duke mos lënë boshllëqe të këtyre pozitave kaq me rëndësi.

Ekipi i vlerësimit pedagogjik

Ekipi i vlerësimit pedagogjik si një ndër ekipet me rëndësi të lartë në edukim special , do ketë në përbërje njerëz professional të cilët kërkohen në udhëzime , përkrahje për nevojat e tyre do jetë e duhur në mënyrë që të arrijmë që asnjë nxënës në komunën tone të mos mbetet pa vlerësim.

Krijimi i ekipeve për mbështetje të shkollave

Duke e pare shtrirjen e shkollave në fshatra, ne do i ofrojmë mbështetje të gjithë nxënësve duke krijuar një ekip i cili do ndihmoj çdo shkollë me planifikime, udhëzime të duhura dhe mbështetje të nevojshme.

Mësimdhënësit mbështetës ,pedagog , psikolog e asistent do kenë mundësinë që si ekip i përbashkët të ndihmoj në shkollat në planifikime si hartimi i planeve mësimore individuale , rishikimin e planeve, dhënien e udhëzimeve të duhura për arsimim, udhëzime për prindër dhe në qështje të tjera të orientimit etj.



#ASHE

Mbështetje për OJQ-të dhe ekspertët që ngrisin cilësinë në Arsimin special

Përshtatja e infrastruktures shkollore brenda dhe jashtë shkollës për nxënësit me dëmtime fizike dhe përdorues të karrocave.

Çerdhet dhe edukimi parashkollor

Fillimisht do të bëhet një analizë e gjendjes nëpër të gjitha çerdhet ekzistuese dhe do të ketë mbështetje komunale për t'i kthyer këto çerdhe në çerdhe bashkëkohore dhe të dashura për fëmijë.

- Hapja e çerdheve të reja në Suharekë, Bllacë dhe Budakovë.

Prindërit e nxënësit pjesë e vendimmarrjes në shkollë

Në të gjitha shkollat do t'i bëjmë funksionale Këshillin e shkollës, Këshillin e nxënësve dhe Këshillin e prindërve. Do të angazhohemi për të nxitur pjesëmarrjen aktive të nxënësve e prindërve në jetën shkollore, duke krijuar mundësi për të diskutuar dhe bashkëpunuar me mësuesit për përmirësimin e mësimi të fëmijëve.

Gjithashtu do të angazhohemi që si nxënësit ashtu edhe prindërit përmes funksionalizimit të Këshillit të tyre t'i bëjmë pjesë të vendimmarrjes në shkollë.



#ASHE

Bursa per nxënës dhe studentë

Përkrahja për nxënësit dhe studentët do të jetë e përhershme.

Nxënësit dhe studentët do të kenë ndihmen tonë në arritjen e sukseseve të tyre. Ata do të përfitojnë bursat sipas rregullores, e që në mandatin tonë qeverisës do të ketë rritje të vlerës së bursave.

Shkëmbimi i përvojave me nxënës nga diaspora

Ne do të subvencionojmë shoqata që merren me organizimin e arsimit në mërgatë dhe do të sjellim nxënës nga mërgata në Suharekë për vizitë shkollave e institucioneve kulturore me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe njohjen e mëtutjeshme të tyre me vendlindjen.

1.2 Kultura, Rinia dhe Sporti

si edukim i mendjes dhe trupit

Vizioni ynë

Kultura, rinia dhe sporti janë shtylla identitare, zhvillimore dhe komunitare për Suharekën. Në vizionin tonë, Suhareka bëhet një qendër e gjallë kulturore, një vatër që mbështet kreativitetin dhe një hapësirë ku rinia dhe sporti marrin frymë lirshëm në institucione funksionale, përfshirëse dhe moderne. Për realizimin e këtij vizioni, do të investohen rreth 3.7 milionë euro në ndërtimin e palestrës së qytetit dhe pishinës me standarde olimpike, si dhe në krijimin e hapësirave rekreative si stazat për Moto Cross, Off Road, skateboard, roller dhe biçikleta.

Çfarë na shqetëson?

Fusha e kulturës në Suharekë është braktisur nga prioritetet publike. Institucionet kulturore kanë mbetur jashtë investimeve serioze dhe janë shndërruar në hapësira pasive pa vizion programor. Shtëpia e Kulturës funksionon si një objekt pa shpirt, pa kalendar vjetor dhe pa staf profesional që mund të zhvillojë ngjarje me impakt për qytetarët dhe artistët lokalë.

Rinia është reduktuar në kategori statistikore. Këshilli i Veprimit Rinor Lokal nuk është funksional dhe asnjë politikë për të fuqizuar pjesëmarrjen, edukimin joformal apo vetëpunësimin e të rinjve nuk është implementuar. Politikat për rininë janë kthyer në premtime boshe dhe aktivitete simbolike që i largojnë të rinjtë nga vendimarrja në vend që t'i angazhojnë.

Sporti, edhe pse përfaqëson potencial të jashtëzakonshëm, ka mbetur i centralizuar vetëm te një klub. Shumë disiplina të tjera janë lënë në mëshirën e entuziazmit individual dhe pa mbështetje infrastrukturore, logjistike apo financiare. Terrenet sportive janë të degraduara, ndërsa klubet e fshatrave po shuhen një nga një për mungesë përkrahjeje.

Çfarë do të bëjmë ndryshe?

- Ndërtimi i palestrës dhe pishinës me standarde olimpike
- “Theranda Got Talent” – festival veror me të rinj nga Theranda dhe mërgata
- Themelimi i Teatrit të Qytetit të Suharekës

Prioritet: Kultura

1. Themelimi i Teatrit të Qytetit të Suharekës

Themelimi i teatrit do të shënojë kthesën më të rëndësishme për jetën kulturore të qytetit tonë. Mungesa e një institucioni të tillë ka bërë që artistët vendorë të mbeten pa skenë, ndërsa publiku pa akses në shfaqje teatrore. Ky teatër nuk do të jetë vetëm një sallë, por një qendër kulturore me program të rregullt, bashkëpunime ndërkombëtare dhe edukim artistik për të rinjtë. Ai do të fuqizojë identitetin lokal dhe do të kthehet në një pikë referimi për zhvillimin e artit skenik në komunë.

2. Rifunksionalizimi dhe legalizimi i Muzeut të Qytetit

Muzeu i Suharekës, aktualisht jashtë funksionit dhe pa status ligjor, përfaqëson potencial të madh edukativ, kulturor dhe turistik. Legalizimi dhe rifunksionalizimi i tij do të krijojë një qendër të dokumentimit dhe promovimit të historisë sonë lokale -nga arkeologjia deri te jeta etnografike. Ai do të shërbejë si vend mësimi për shkollat, si hapësirë kërkimi për studiuesit dhe si atraksion për vizitorët.

3. Mbështetje për hulumtime arkeologjike dhe trashëgimi kulturore

Territori i Suharekës është i pasur me gjetje arkeologjike që mbesin të pashfrytëzuara. Mbështetja institucionale për hulumtime arkeologjike do të mundësojë zbulimin, dokumentimin dhe promovimin e trashëgimisë së komunës. Kjo nuk është vetëm një çështje identiteti, por edhe mundësi për zhvillim kulturor, turistik dhe ekonomik. Pa hulumtim nuk ka histori, pa histori nuk ka vetëdije.

Prioritet: Rinia

1. Qendra Inovative për të Rinj

Rinia e Suharekës ka ide, energji dhe potencial, por i mungojnë hapësirat ku mund të shprehet. Objektin të ish-tregu javor do ta bëjmë qendër inovative për rini. Qendra Inovative do të krijojë kushte për mësim, krijimtari, bashkëpunim dhe ndërlidhje me rrjetet kombëtare e ndërkombëtare.

2. Podcasti i Rinisë

Përmes Podcastit të Rinisë, të rinjtë do të kenë zërin e tyre publik dhe një platformë për të trajtuar temat që i preokupojnë. Kjo iniciativë synon aktivizimin, përfshirjen dhe fuqizimin e gjeneratës së re.

3. Linjë telefonike për Shëndet Mendor

Shëndeti mendor është një prej sfidave më të mëdha të të rinjve sot dhe duhet trajtuar pa tabu. Linja për shëndet mendor do të ofrojë ndihmë profesionale dhe diskrecion të plotë.

Prioritet: Sporti

1. Palestra dhe Pishina me Standarde Olimpike

Suhareka, qyteti i kampionëve, ka arritur shumë në sport me shumë pak infrastrukturë. Palestra dhe pishina me standarde olimpike janë investime që do t'i japin fund kësaj kontradike. Këto dy objekte do të mundësojnë zhvillimin e talentëve të rinj, organizimin e garave, rritjen e aktivitetit fizik dhe përfshirjen e të gjitha grupmoshave në sport. Ato do të bëhen epiqendër e sportit në rajon dhe burim krenarie për qytetin tonë.

Ky projekt do të jetë pikë referimi për shkollat në Komunë, ku nxënësit e shkollave do të kenë mundësi të zhvillojnë aktivitetet e tyre sportive përkrah lëndës së Edukatës Fizike.

2. Ndërtimi i stazës për skateboard, roller dhe biçikleta

Do të ndërtojmë një stazë moderne për skateboard, patina dhe biçikleta në zonë urbane. Ky investim synon të përfshijë të rinjtë në aktivitete rekreative dhe të shëndetshme në ambient të hapur. Hapësira do të jetë funksionale, kreative dhe e sigurt për praktikuesit e sporteve alternative.

3. Mbështetje financiare për klubet sportive të qytetit

Klubet sportive të Suharekës kanë shënuar suksese të jashtëzakonshme në nivel vendor dhe ndërkombëtar, pavarësisht mungesës së mbështetjes së qëndrueshme. Ne do të ndajmë subvencione të rregullta dhe transparente për të gjitha klubet e qytetit, pa dallim, për të rritur kapacitetet dhe pjesëmarrjen në garat kombëtare e ndërkombëtare. Sporti do të trajtohet si pjesë e rëndësishme e zhvillimit shoqëror dhe rinor të komunës.

Intervenime të tjera me rëndësi për komunën tonë

Kulturë

- Theranda got talent: festival verore me te rinj nga Theranda dhe mërgata
- Mbrojtje e trashëgimisë kulturore: zonave, objekteve, peizazheve



#ASHE

- Mbështetje për hulumtime, botime, guida dhe promovim të trashëgimisë
- Investime në Bibliotekën “Hajdin Berisha” dhe rifunksionalizimi i SHKA-ve
- Subvencione për ekspozita, kinema dhe biznese kulturore
- Teatër multifunksional përfshirë teatër kukullash
- Bashkëpunime me teatrot kombëtare dhe ndërkombëtare
- Muzeu mobil si projekt edukativ, me kalendar vizitash në komuna të tjera
- Organizimi i festivaleve kulturore të përvitshme

Rini

- Themelimi i Shkollës Verore për të Rinj
- Edukim joformal për të rinjtë, trajnime për të menduarin kritik dhe aktivizëm
- Njohja dhe certifikimi i punës vullnetare si përvojë pune

*#Kulturë,
Rini dhe Sport*



#ASHE

Sport

- Mbështetje e rregullt financiare për klubet sportive në bazë të performancës dhe transparencës
- Ndërtimi i stazës për Moto Cross dhe Off-Road
- Ndërtimi i stazës për skateboard, roller dhe biçikleta
- Themelimi i Javës së Sportit në Suharekë
- Mbështetje për turne dhe gara në sporte të ndryshme, përfshirë e-sports
- Krijimi i programeve falas të stërvitjes për fëmijë dhe të rinj
- Fushata vetëdijësuese “Lëviz pak, jeto gjatë”
- Pajisje dhe terrene për fitness publik në lagje

#Kulturë,
Rini dhe Sport

1.3 Gratë

Vizioni ynë

Zhvillimi i Suharekës nuk mund të jetë i plotë pa përfshirjen e grave në mënyrë të barabartë dhe të strukturuar. Ne besojmë se gratë nuk janë vetëm pjesë e komunitetit-janë faktor i pashmangshëm zhvillimi në çdo fushë: nga ekonomia te politika, nga bujqësia te arsimi. Fuqizimi i grave dhe avancimi i rolit të tyre nuk është thjesht çështje barazie, por një domosdoshmëri për ndërtimin e një komune gjithëpërfshirëse dhe funksionale.

Çfarë na shqetëson?

Roli i gruas në vendimmarrje, në Suharekë dhe në nivelin lokal në përgjithësi, vazhdon të mbetet periferik. Gratë janë nënperfaqësuar në organet vendimmarrëse, zërat e tyre janë të padëgjuar në proceset publike, dhe mundësitë për zhvillim ekonomik, profesional apo politik janë të pabarabarta. Kjo pabarazi strukturore i ka kushtuar komunës me humbjen e potencialit të gjysmës së shoqërisë.

Çfarë do të bëjmë ndryshe?

- Krijimi i Këshillit të Grave të Komunës
- Mbështetje e start-up-eve të grave
- Mbështetje të drejtpërdrejtë në bujqësi për gratë fermere
- Mbështetje me pagë për nënat lehona – 100% e pages për 9 muaj

Çfarë do të bëjmë ndryshe? (Prioritetet kryesore)

- Do të krijojmë Këshillin e Grave të Komunës, me përfaqësim nga çdo lagje dhe fshat, për të siguruar pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në konsultimet dhe vendimmarrjet lokale. Ky këshill do të jetë trup këshillëdhënës, por me ndikim real në politikat publike, përmes pjesëmarrjes në planifikimet komunale, konsultimet për buxhetin dhe hartimin e programeve zhvillimore. Ai do të shërbejë si platformë për ngritjen e zërit të grave në çdo fushë-nga arsimi e kultura te infrastruktura dhe ekonomia. Gratë do të kenë hapësirën e tyre të strukturuar për të vendosur dhe jo vetëm për të dëgjuar.



#ASHE

• **Do të mbështesim start-up-et e grave, përmes subvencioneve deri në 5 mijë euro për gratë që hapin biznese në Suharekë.** Ky grant do të jetë pa kthim, dhe i orientuar posaçërisht në idetë që kontribuojnë në zhvillimin lokal, punësim dhe inovacion. Përveç mbështetjes financiare, përfitueset do të përfshihen edhe në trajnime praktike për menaxhimin e biznesit, marketingun dhe qasjen në treg. Gratë sipërmarrëse nuk do të jenë më përjashtim-por pjesë aktive e motorit ekonomik të komunës.

• **Do të ofrojmë mbështetje të drejtpërdrejtë në bujqësi për gratë fermere,** për t'i fuqizuar si prodhuese dhe si menaxhere të ekonomisë familjare. Kjo do të bëhet përmes subvencioneve të veçanta, granteve të aksesueshme dhe asistencës teknike në çdo fazë të prodhimit. Në bashkëpunim me organizatat partnere, do të organizojmë trajnime dhe këshillim bujqësor të specializuar për gratë. Fermeret gra nuk do të mbesin në hije-por do të jenë pararojë e bujqësisë moderne dhe të qëndrueshme në Suharekë.

#Gratë

Mbështetje me pagë për pushimin e lehonisë për gratë e punësuar në sektorin privat

Për të ofruar siguri grave që janë në marrëdhënie pune gjatë shtatzënisë dhe për të lehtësuar bizneset që punësojnë gra, Komuna do të subvencionojë për 6 muajt e parë pas lindjes 70% të pagës mujore për nënat lehona. Kjo masë synon të mbrojë nënat dhe fëmijët, duke garantuar stabilitet dhe duke krijuar një ambient më të sigurt e më të favorshëm për punësim dhe zhvillim familjar.

Intervenime të tjera me rëndësi për komunën tonë

- Do të ndajmë **bursa për trajnime profesionale**, me qëllim që gratë të përfshihen në mënyrë aktive dhe të qëndrueshme në tregun e punës.
- Do të themelojmë **Akademinë Komunale për Mendimin Politik të Grave**, një hapësirë edukimi dhe rrjetëzimi për gratë që duan të angazhohen në politikë, qeverisje dhe aktivizëm lokal.
- Do të organizojmë **debate publike dhe dëgjime tematike** ku gratë do të jenë aktore të drejtpërdrejta dhe jo vetëm të ftuara simbolike.

1.4 Turizmi

Identiteti i ri i Suharekës (Bjeshka dhe Qyteti)

Vizioni ynë

Për ne, turizmi nuk është vetëm një katalizator ekonomik, por një mjet edukimi dhe rilidhjeje të gjeneratave me natyrën, historinë dhe të ardhmen. Ne synojmë ta kthejmë Suharekën në një qendër turistike rajonale me ndikim kulturor, social dhe ekonomik, përmes një vizioni 10-vjeçar që bashkon qytetin dhe bjeshkën në një identitet të ri zhvillimi. Si fazë e parë e vizionit do ndërtohen 30km shtigje malore dhe një teleferik me gjatësi 5km.

Për realizimin e këtij vizioni, do të synohet sigurimi i rreth 11.5 milionë eurove. Fondet fillestare do sigurohen nga komuna, ndërsa investimet në ndërtim planifikohet të mbulohen përmes granteve ndërkombëtare, si: Instrumenti i Para-Aderimit (IPA), Green Agenda, Regional Development of Tourism, EBRD, KfW, SECO, World Bank, UNDP, GIZ dhe fonde të tjera për zhvillim të qëndrueshëm dhe mbrojtje të mjedisit.

1.4 Turizmi

Çfarë na shqetëson?

Sektori i turizmit në Suharekë është lënë në harresë, pavarësisht potencialit të madh. Mungojnë investimet në infrastrukturën turistike, si rrugët lidhëse për te atraksionet natyrore e historike, mungon sinjalistika turistike dhe hapësirat publike janë të papërshtatura për vizitorët.

Përkundër vlerave arkeologjike e kulturore të komunës, nuk ka asnjë strategji serioze për zhvillim, promovim apo mbrojtje të tyre. Atraksionet janë të pidentifikuara dhe të papromovuara, ndërsa objektet me vlerë kulturore shpesh mbesin të paqasshme ose në gjendje të keqe.

Mikro-bizneset që operojnë në fushën e turizmit nuk kanë asnjë mbështetje institucionale, ndërsa mungesa e bashkëpunimit me sektorin privat dhe me komunitetin vendor ka lënë këtë sektor jashtë fokusit zhvillimor të komunës.

Çfarë do të bëjmë ndryshe?

- Shtigje natyrore për ecje, kalërim dhe biçikleta
- Një linjë teleferiku nga qyteti në zona panoramike

Agroturizëm – Mbështetja e prodhimeve vendore dhe ushqimeve tradicionale me synim zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe forcimin e lidhjes mes vizitorëve dhe kulturës lokale.

Do të realizojmë fazën e parë të projektit “Bjeshka dhe Qyteti”, i cili e lidh Suharekën me të ardhmen përmes:

Ndërtimi i rrjetit të integruar të shtigjeve malore (30 km)

Do të ndërtojmë një rrjet të gjerë shtigjesh malore për ecje, kalërim dhe biçikleta, që përfshin 30 kilometra infrastrukturë natyrore me standarde të larta. Këto shtigje do të jenë të aksesueshme gjatë gjithë vitit, të qëndrueshme për përdorim të vazhdueshëm dhe të përshtatshme për të gjitha moshat dhe kategoritë e vizitorëve.

Shtigjet do të ndërtohen me gjerësi nga 4 deri në 6 metra dhe do të shtrohen me shtresë zhavorri të ngjeshur për qëndrueshmëri dhe siguri maksimale në terren të ndryshëm. Në segmentet strategjike do të vendoset ndriçim solar për siguri gjatë mbrëmjeve dhe netëve të vona, sidomos në afërsi të bujtinave dhe stacioneve hyrëse.

Për të ruajtur karakterin natyror dhe për të ofruar një përvojë autentike, do të ndërtohen ura druri mbi rrjedha natyrore, do të instalohen ndalesa për pushim me stola dhe streha, si dhe pika panoramike për soditje të peizazheve. Ky rrjet do të jetë i integruar me burime natyrore, duke përfshirë edhe ujësjellës të vegjël dhe kroje funksionale në zonat më të frekuentuara.

Për të lehtësuar orientimin e vizitorëve, secili shteg do të jetë i pajisur me shënime digjitale dhe informacione që mund të aksesohen përmes një **aplikacioni mobil të komunës**, që do të shërbejë si guidë interaktive për të gjitha atraksionet malore.

Realizimi i një linje teleferiku

Do të ndërtojmë një linjë teleferiku me gjatësi 5 kilometra, që do të lidh qytetin dhe fshatrat me majat më panoramike të komunës, si Antena dhe Guri i Dellocit. Teleferiku do të pajiset me kabina moderne dhe do të ketë stacione shërbimi në pikënisje dhe në majë, duke përfshirë objekte me nyje sanitare, pika vrojtimi, kioska informative dhe hapësira për pajisje sportive ose konsum të ushqimeve të shpejta. Teleferiku do të shërbejë jo vetëm si mjet ekologjik lëvizjeje, por edhe si atraksione turistike vetvetiu. Donacionet për kabinat dhe bashkëpunimet ndërkombëtare do të reduktojnë ndjeshëm kostot financiare për komunën.

Krijimi i rrjetit të integruar turistik dhe transportit urban

Do të ndërtojmë një rrjet të integruar që lidh fshatrat malorë me njëri-tjetrin, me qendrën e qytetit dhe me shtigjet ekzistuese. Ky rrjet do të përfshijë linja të reja të autobusëve ekologjikë dhe minibusëve turistikë që ndjekin itinerare të planifikuara për vizitorët. Do të shqyrtojmë edhe mundësinë e një tramvaji lokal që lidh stacionin e autobusëve me pjesët kryesore të qytetit, si dhe integrimin me linjën hekurudhore ekzistuese. Synojmë krijimin e një sistemi të bashkërenduar transporti që e vendos Suharekën në qendër të lëvizshmërisë së qëndrueshme rajonale.



#ASHE

Krijimi i markës turistike “**Suhareka Turistike**” dhe identitetit vizual të destinacionit

Do të dizajnojmë dhe promovojmë një markë të re turistike për Suharekën, duke përfshirë logo, slogan dhe identitet të veçantë vizual që e dallon komunën në hartën turistike të rajonit. Kjo markë do të shoqërohet me materiale promocionale, dizajn për qendra informuese turistike, tabela orientuese, si dhe një fushatë të gjerë digjitale që përfshin video, platforma sociale dhe ekspozita në panairë ndërkombëtare.

Zhvillimi i aplikacionit “**Vizito Suharekën**” dhe guidës dixhitale

Do të zhvillojmë një aplikacion mobil interaktiv dhe një uebfaqe moderne nën emrin “Vizito Suharekën”, që do t’u mundësojë turistëve të kenë qasje të menjëhershme në informacion mbi shtigjet malore, bujtinat tradicionale, atraksionet kulturore, gastronominë vendore, ngjarjet sezonale dhe shërbimet publike. Aplikacioni do të përfshijë harta të integruara, audio-guida, rekomandime sipas interesave dhe mundësi rezervimi për akomodim dhe eksperiencë.

Organizimi i ngjarjes vjetore “Dita e Turizmit – Suhareka Turistike”

Do të organizojmë një ngjarje të përvitshme të quajtur “Dita e Turizmit – Suhareka Turistike”, e cila do të shndërrohet në një festival të përmasave rajonale. Brenda kësaj ngjarjeje do të përfshijmë tregje artizanale dhe bujqësore, vizita të organizuara në atraksione natyrore e historike, gara rekreative, debate publike për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, si dhe muzikë e kulturë vendore. Kjo do të shërbejë si pikë takimi për komunitetin, prodhuesit lokalë dhe turistët.

Mbështetja e agroturizmit dhe zhvillimi i bujtinave familjare

Do të fuqizojmë agroturizmin përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë financiare dhe teknike për familjet që duan të zhvillojnë bujtina, ferma për vizitorë dhe produkte lokale me origjinë të kontrolluar. Zhvillimi do të përqendrohet në fshatrat me potencial të lartë si Budakova, Papazi, Vëresheci, Greiçeci, Maqiteva, Mushtishti, Delloci dhe Greikoci. Do të ofrojmë trajnime për guida, menaxhim mikpritjeje, higjienë dhe promovim online, duke e lidhur prodhimin vendas me ofertën turistike.

Aktivizimi i potencialit për turizëm të bardhë dhe sporte dimërore

Do të hartojmë një strategji për zhvillimin e turizmit dimëror, duke u fokusuar në shpatet e Sharrit që i përkasin Suharekës – zona që orientohet nga veriu, verilindja dhe veriperëndimi dhe që ofron kushte ideale për skijim dhe sporte të bardha. Do të hartojmë një plan fizibiliteti për ndërtimin e pistave, pajisjeve ndihmëse dhe trajnimin e stafit lokal për mirëmbajtje dhe menaxhim të sezonit dimëror. Ky segment do të diversifikojë ofertën turistike dhe do të gjenerojë të ardhura gjatë gjithë vitit.

Riorganizimi i qasjes edukative dhe promovuese në turizëm

Turizmi nuk do të trajtohet vetëm si sektor ekonomik, por si pjesë e formimit qytetar dhe edukimit përmes përvojës. Në bashkëpunim me shkollat, do të organizojmë aktivitete edukative në natyrë, ekskursione, gara sportive dhe klube hiking për nxënësit dhe të rinjtë. Kjo do të krijojë lidhje të hershme me trashëgiminë dhe ambientin, si dhe do të mbështesë zhvillimin e një kulture të respektit dhe përkujdesjes për hapësirën publike dhe natyrën.

2. Shërbimet

përditshmëria jonë, mirëqenia jonë

Vizioni ynë

Shërbimet publike janë pasqyra më e drejtpërdrejtë e marrëdhënies mes qytetarit dhe komunës. Në zemër të këtij kapitulli qëndron angazhimi ynë për të rikthyer dinjitetin e qytetarit përmes kujdesit të merituar në çdo aspekt të jetës së përditshme. Shëndetësia, e cila sot është e mbingarkuar, e ngadaltë dhe shpesh përjashtuese, do të trajtohet si një e drejtë e pakushtëzuar. Ne synojmë një sistem të përfshirjes së plotë, me infrastrukturë moderne, staf të motivuar dhe shërbime cilësore që vendosin pacientin në qendër.

Infrastruktura, që tradicionalisht është parë si trofe politik me kilometra asfalt, do të trajtohet si shërbim i planifikuar me mendje, i ndërtuar me standarde dhe i orientuar drejt sigurisë, qasjes dhe funksionalitetit. Rrugët, ndriçimi, sinjalistika dhe hapësirat publike do të jenë pjesë e një vizioni për qytetin e mençur dhe fshatrat e lidhura denjësisht me qendrën.

Në këtë kuadër, administrata komunale duhet të jetë jo vetëm funksionale, por miqësore me qytetarin. Përmes një reforme të thellë të shërbimeve publike, digjitalizimit dhe thjeshtimit të procedurave, do të krijojmë një shërbim civil efikas, pa burokraci, që respekton kohën dhe dinjitetin e çdo individi, nga qendra urbane deri në fshatin më të largët.

Njëkohësisht, do t'i japim prioritet absolut mjedisit, jo si temë sipërfaqësore për fushata, por si politikë e përditshme për një komunë të pastër dhe të qëndrueshme. Ndarja në burim, riciklimi dhe eliminimi i deponive ilegale do të jenë pjesë e një reforme që përfshin qytetarët, institucionet dhe bizneset në një përpjekje të përbashkët për mbrojtjen e natyrës.

Përballja me emergjencat nuk duhet të fillojë pas zjarrit apo përmbytjes, por para tyre. Do të investojmë në ndërtimin e një sistemi funksional për menaxhimin e rreziqeve, që parandalon, ndërhyr me kohë dhe mbron jetën dhe pronën e qytetarëve, pa e kthyer çdo krizë në spektakël politik.

E mbi të gjitha, mërgata jonë nuk do të trajtohet më si “bankomat i verës”. Ndryshe nga qasja aktuale që i sheh vetëm si potencial për zhvillim ekonomik, ne do të jemi në shërbim të tyre, me procedura të lehtësuara, qasje të drejtpërdrejtë në shërbime komunale dhe një ndjesi të fortë të përkatësisë. Sepse vendlindja nuk duhet të kërkojë vetëm, por edhe të ofrojë.

Përmes kësaj shtylle, që përfshin shëndetësinë, infrastrukturën, administratën komunale, mjedisin, emergjencat dhe mërgatën, do të ndërtojmë themelet e një përditshmërie më të denjë për secilin qytetar.

Për realizimin e këtyre angazhimeve do të investohen rreth 26 milionë euro gjatë katër viteve të ardhshme, në funksion të mirëqenies së përbashkët dhe rikthimit të besimit të qytetarit në shërbimin publik.

2.1 Shëndetësia

kujdes për të gjithë

Vizioni ynë

Shëndetësia dhe mirëqenia sociale e qytetarëve do të jenë një nga prioritetet kryesore të mandatit tonë qeverisës. Besojmë në një sistem shëndetësor komunal gjithëpërfshirës, të barabartë dhe modern, i cili siguron qasje cilësore për të gjithë, pa përjashtime.

Për realizimin e këtij vizioni, do të investohen rreth 4.5 milionë euro në ndërtimin e QKMF-së së re në Suharekë, përforcimin e kontrollit mbi barnat esenciale, pajisjen e laboratorëve për kujdesin parësor dhe ndërtimin e AMF-së në Nishor bashkë me renovimin e objekteve ekzistuese.

Çfarë na shqetëson?

Sistemi aktual i Kujdesit Parësor Shëndetësor vuan nga mungesa e infrastrukturës së përshtatshme, furnizimit të rregullt me barna dhe burimeve të mjaftueshme njerëzore. Qytetarët përballen me lista të gjata pritjeje, pajisje të vjetruara, shërbime të ngadalshme, si dhe mungesë të përkujdesjes për kategoritë më të ndjeshme. Kujdesi social është shpesh fragmentar dhe pa koordinim të duhur me institucionet komunale.

Çfarë do të bëjmë ndryshe?

- Ndërtimi i objektit të ri të QKMF-së “Rexhep Kuçi”
- 1,250 euro për fëmijën e tretë dhe 4, 000 euro për fëmijën e katërt
- Ngritja e kapaciteteve për diagnostikim

Çfarë do të bëjmë ndryshe? (Prioritetet kryesore)

1. Ndërtimi i QKMF-së “Rexhep Kuçi” në Suharekë

Qendra ekzistuese e Mjekësisë Familjare nuk i plotëson as kushtet minimale për ofrim të shërbimeve cilësore. Do të ndërtojmë QKMF-në e re sipas standardeve moderne evropiane, të bazuar në hartën zonale dhe planin strategjik të zhvillimit të komunës, duke siguruar qasje për të gjithë qytetarët.

2. Ngritja e kapaciteteve për diagnostikim

Për të rritur cilësinë e diagnostikimit në kujdesin parësor shëndetësor, do të investojmë në ndërtimin e një kabineti modern të imazherisë diagnostike, të pajisur me aparaturë digjitale për ekzaminime radiologjike dhe RTG për dhëmbë. Laboratorët do të pajisen me të gjitha pajisjet e nevojshme për të kryer analizat që parashihen me ligj për këtë nivel të kujdesit. Krahas kësaj, do të rrisim cilësinë e shërbimeve laboratorike dhe radiologjike duke përmirësuar pajisjet, kapacitetet dhe qasjen për pacientët. Një fokus i veçantë do t'i kushtohet shtimit të mamografive ditore, me qëllim që të shkurtohen listat e pritjes dhe të përmirësohet zbulimi i hershëm i sëmundjeve.

3. Subvencion për lindje

Në mbështetje të familjeve të reja dhe për të inkurajuar lindjet në komunën tonë, do të ofrojmë subvencione të drejtpërdrejta për fëmijën e tretë dhe të katërt. Çdo familje që sjell në jetë fëmijën e tretë do të përfitojë 1, 250 Euro, ndërsa për fëmijën e katërt do të ndahen 4, 000 Euro. Kjo masë do të lehtësojë barrën ekonomike për familjet dhe do të përforcojë kujdesin institucional për rritjen e popullsisë në komunën tonë.

Intervenime të tjera me rëndësi për komunën tonë

- Përkujdesje e veçantë për familjet e dëshmorëve, veteranëve dhe të pagjeturve.
- Ndihmë për rastet sociale dhe mbulim i shpenzimeve mortore për familjet në nevojë.
- Mbështetje për nënat dhe fëmijët me vizita shtëpiake nga shtatzënia deri në moshën 3 vjeç.
- Mbështetja për gratë e punësuar në sektorin privat pas lindjes - subvencionimi i pushimit të lehonisë.
- Kontroll mbi barnat esenciale që shpërndahen në komunë.
- Transport i organizuar për pacientët që ndjekin terapi dialize.
- Përkrahje ekonomike për çdo lindje në maternitetin komunal.
- Shtim i stafit për përkujdesje shtëpiake dhe funksionalizim i AMF-ve në zonat rurale.
- Ofrimi i shërbimeve të shëndetit oral në shkollë si projekte pilot.
- Ligjërata nga stomatologët për shëndetin oral të nxënësve.
- Fushata për parandalimin e abuzimit me duhan, alkool dhe substanca narkotike.
- Kujdes i shtuar për higjienën personale dhe ambientale në shkollë e institucione shëndetësore.
- Dyfishim i buxhetit për produkte medicinale dhe shpërndarje e rregullt e barnave.
- Hartimi i orareve fikse për shpërndarjen e barnave dhe materialeve shpenzuese.
- Ndërtimi i AMF-së në fshatin Nishor dhe renovimi i objekteve ekzistuese sipas standardeve bashkëkohore.
- Kalimi në sistemin e ngrohjes me pompa termike si model ekologjik dhe efikas.

2.1 Infrastruktura

së pari si shërbim

Vizioni ynë

Ndëtojmë një qytet të mençur dhe të sigurt, ku teknologjia i shërben qytetarëve për të rritur cilësinë e jetës, për të parandaluar rreziqet dhe për të forcuar besimin në hapësirat publike. Në këtë qytet, trafiku menaxhohet në mënyrë inteligjente për të garantuar siguri maksimale dhe rrjedhshmëri të qëndrueshme, duke reduktuar aksidentet dhe vonesat.

Për realizimin e këtij vizioni, do të investohen rreth 15.3 milionë euro në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore në të gjitha zonat e Komunës së Suharekës, përfundimin e unazës së qytetit dhe rrugëve lidhëse, ndërtimin e parkingut me kate, funksionalizimin e sheshit të qytetit, digjitalizimin e sistemit të sigurisë publike, mobilitetin urban dhe aksesin për persona me nevoja të veçanta, si dhe për përmirësimin e infrastrukturës shkollore.

Krahas kësaj, është planifikuar një seri investimesh jetike në fushën e ujësjellësit dhe kanalizimit, që përfshijnë: mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimit “Pusi i Atit” (duke shtuar dy puse të reja), zëvendësimin e gypit të vjetër ACC drejt Shirokës, hapja e dy pusesve të Damperi, finalizimin e rrjetit të ujësjellësit në zonën industriale, përmirësimin e sistemit në fshatrat Grekoc dhe Sopijë, dhe zhvillimin e studimeve, hulumtimit për sigurimin e burimeve të reja. Duhla, Nishori, Sllapuzhani, Baçeci do të kenë furnizim të mjaftueshëm të ujit. Përmes KRU Gjakova - hidrosistemi i Radoniqit do të rriten kapacitetet e ujit për fshtatrat: Samadraxhë, Studençan, Njëpërbisht dhe Tërrnje.

Do ti kushtohet rëndësi e veçantë projektit – Liqeni i Dragaginës.

Po ashtu, do të investohet në studimin dhe ndërtimin e rrjeteve të kanalizimit dhe fillimin e projekteve për ndarjen e ujërave atmosferike nga ato të ndotura.

Kostoja totale për këto ndërhyrje në sektorin e ujit dhe kanalizimeve vlerësohet në rreth 1.6 milionë euro, ndërsa investitorët potencialë për realizimin e tyre do të përfshijnë buxhetin komunal, Qeverinë e Kosovës, fondet e BE-së (IPA), BERZH, Bankën Botërore, KfW-në, UNDP, si dhe partneritete publiko-private në bazë të interesave të përbashkëta për zhvillim të qëndrueshëm.

Çfarë na shqetëson?

Jehona më e madhe e investimeve kapitale në Suharekë ka qenë ajo e përqendruar te infrastruktura: rrugë, rrugica, parqe e ndriçim publik. Por e vërteta është krejt ndryshe. Cilësia e punëve lë shumë për të dëshiruar – në disa raste, është thjesht e pafalshme. Rrugët në fshatin Vraniq janë paguar pesë herë, por rezultatet janë zhgënjyese. Projektet që është dashur të përfundojnë për dy muaj, kanë zgjatur dy vjet. Plani dinamik është shkelur në vazhdimësi, ndërsa qytetarët janë lënë në pritje pafund.

Asfaltimi pa standarde, mungesa e mbikëqyrjes dhe përdorimi i materialeve jo cilësore janë kthyer në rregull, jo përjashtim. Kjo ka prodhuar infrastrukturë jo vetëm të papërfunduar, por edhe të rrezikshme. Këmbësorët, personat me nevoja të veçanta dhe biçiklistët janë sistematikisht të anashkaluar. Mungon ndriçimi adekuat në rrugët dytësore, sinjalistika është e vjetruar ose nuk ekziston fare, dhe në shumë raste, rrugët janë pa mirëmbajtje bazike –as dimërore, as sezonale.

Në vend të një qyteti të mirëmenaxhuar, kemi përballë një realitet të fragmentuar, me kanalizime të pamjaftueshme, trafik të ngarkuar dhe zero transparencë për planifikimin e investimeve. Dhe pikërisht kjo mungesë transparence dhe llogaridhënieje ka bërë që qytetarët të mos jenë pjesë e prioritizimit të nevojave reale të lagjeve dhe fshatrave të tyre.

Çfarë do të bëjmë ndryshe?

- Burimi i “Pusi i Atit” – Garanci për ujin e të ardhmes
- Përfundimi i unazës së qytetit
- “Smart & Safe City” – Qytet i mençur dhe i sigurt për të gjithë (kamera inteligjente, sinjalistikë, ndriçim efikas)

Prioritetet kryesore në Infrastrukturë

1. Furnizimi me ujë dhe kanalizimi -zgjidhje themelore për një komunë funksionale

Problemet me furnizimin me ujë të pijshëm dhe kanalizimin në shumë fshatra e lagje urbane janë bërë të padurueshme. Rrjeti ekzistues është i vjetruar, me humbje të mëdha teknike dhe shtypje të dobët, sidomos gjatë sezonit veror. Kanalizimi mbetet i përzier -ujërat e zeza dhe ato atmosferike shkarkohen në të njëjtat rrjete, duke rrezikuar mjedisin dhe shëndetin publik.

Ne synojmë një transformim të plotë në këtë sektor përmes:

- Zgjerimit të rrjetit të ujësjellësit në zonat pa qasje, duke përfshirë burime të reja dhe fuqizimin e puseve ekzistuese.
- Rindërtimit të segmenteve të dëmtuara dhe reduktimit të humbjeve teknike.
- Ndërtimit të rrjetit të ri të kanalizimeve me ndarje të ujërave të zeza dhe atmosferike dhe ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura në Grekoc dhe Bllacë.

Burimi “Pusi i Atit” – Garanci për ujin e të ardhmes

Ky burim furnizon shumicën e qytetit dhe fshatrave përreth. Aktualisht rrezikohet nga mungesa e mbrojtjes ligjore, shfrytëzimi joefikas dhe lidhjet e pakontrolluara.

Do të ndërmarrim:

- Masa për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të zonës së burimit.
- Hapjen e dy puseve të reja që do të rrisin kapacitetin për 30 litra në sekondë.
- Ndërtimi i rezervuarit grumbullues me vëllim prej 2000m³.
- Investim në rrjetin sekondar për të eliminuar gypin e vjetër ACC 300 mm drejt Shirokës.

Zona industriale e Shirokës -ujë për zhvillim ekonomik

Investimet e kaluara në rrjet janë lënë përgjysmë, ndërsa bizneset në këtë zonë përballen me mungesë uji, lidhje të paligjshme dhe rrjet të dëmtuar.

Ne do të:

- Testojmë rrjetin e lënë në gjysmë.
- Finalizojmë nyjet teknike dhe realizojmë kyçjet për bizneset.
- Lidhim këtë rrjet me sistemin kryesor, për furnizim të qëndrueshëm.

2. Përfundimi i unazës së qytetit

Unaza ndihmon në shmangien e trafikut të rënduar në qendër të qytetit, automjetet që nuk kanë nevojë të kalojnë nëpër qendër do të devijohen, duke reduktuar ngarkesën e komunikacionit dhe ndotjen në pjesën urbane zona qendër.

3. Smart and Safe city - Kamera inteligjente dhe ndriçim

Një qytet i mençur dhe i sigurt nuk është thjesht dëshirë, është ajo që na duhet përditë. Në një Suharekë që rritet, teknologjia duhet të vihet në funksion të jetës: për të parandaluar rreziqet, për të ndriçuar lagjet, për të edukuar qytetarët dhe për të siguruar fëmijët.

Koncepti Smart & Safe City sjell kamera inteligjente, sinjalistikë që reagon me kohë reale, platforma për raportim dhe ndriçim efikas -jo thjesht si pajisje, por si garanci për siguri dhe transparencë.

Ky model nuk është vetëm urban, por edhe edukativ dhe ekologjik: promovon kulturën në trafik, mbron ambientin dhe krijon partneritet mes komunës, qytetarëve dhe teknologjisë. Vetëm kështu Suhareka bëhet qytet i jetueshëm -ditën dhe natën.

Intervenime të tjera me rëndësi për komunën tonë

- Ndërtimi i impiantit për pastrimin e ujërave të ndotura në fshatrat Greikoc dhe Bllacë.
- Investime kapitale në kanalizim dhe fillimin e projektit për ndarjen e ujërave atmosferike nga ato të zeza.
- Ndërtimi i parkingut me etazhitet në qendër të qytetit.
- Funksionalizimi i linjës urbane dhe pilot-projekti i linjave ndërurbane në 5 fshatra.
- Ndërtimi i unazës së jashtme që lidh fshatrat me rrugën N-25.
- Trajtimi i objekteve për qasjen e personave me nevoja të veçanta.

2.3 Administrata

pa pritje të gjata, me shërbime efikase

Vizioni ynë

Administrata komunale është pasqyra e qeverisjes. Në thelb të qeverisjes sonë qëndron një administratë publike profesionale, transparente dhe efikase, që i shërben qytetarit me dinjitet dhe përgjegjësi. Synimi ynë është krijimi i një shërbimi publik bashkëkohor, të organizuar dhe të përqendruar te nevojat reale të qytetarëve të Suharekës.

Për këtë qëllim, do të investohen 5 milionë euro në ndërtimin e objektit të ri të komunës, si hap konkret drejt krijimit të një administrate funksionale dhe moderne, që ofron shërbime të integruara në një hapësirë të vetme dhe me kushte të dinjitetshme për punë e shërbim ndaj qytetarëve.

Çfarë na shqetëson?

Administrata komunale në Suharekë është sot një strukturë e shpërndarë dhe e paorganizuar, që prodhon më shumë pengesa sesa zgjidhje për qytetarët. Qytetarët, veçanërisht ata në zonat rurale, përballen me burokraci të panevojshme, mungesë koordinimi institucional dhe shërbime të fragmentuara.

Dështimi për të funksionalizuar në tërësi sistemin “One Stop Shop” ka bërë që qytetari të endet nëpër zyrat e ndryshme për një dokument të vetëm. Shpërndarja e administratës në ndërtesa të ndryshme dhe lokacione të paaksesueshme është bërë një pengesë reale për qasje të barabartë në shërbime.

Për më tepër, dy mandatet e fundit kanë dëshmuar mungesë totale të vullnetit për të reformuar administratën –me projekte të papërfunduara, mungesë investimesh në infrastrukturë dhe dështim për të integruar teknologjinë në shërbim të qytetarit. Shërbimi civil është lënë pa standarde, pa pajisje dhe pa vizion

Çfarë do të bëjmë ndryshe?

- Sistemi “One Stop Shop” – të gjitha shërbimet në një vend
- Ndërtimi i objektit të ri të komunës
- Riorganizimi i Administratës

Prioritetet kryesore

1. Të gjitha shërbimet në një vend -Sistemi One Stop Shop

Qytetarët nuk do të kenë më nevojë të kalojnë nëpër shumë sportele e zyra për të marrë një shërbim të thjeshtë. Do të funksionalizojmë sistemin e plotë “One Stop Shop”, ku të gjitha shërbimet komunale do të ofrohen në një dritare të vetme. Ky sistem do të shfrytëzojë infrastrukturën ligjore ekzistuese dhe do të integrohet me platformat digjitale shtetërore për aplikime dhe verifikime online. Në këtë mënyrë, do të shkurtohen kohët e pritjes, do të ulët kontakti fizik dhe do të rritet efikasiteti i shërbimeve publike.

2. Ndërtimi i objektit të ri të komunës

Ndërtimi i komunës së re do të krijojë një hapësirë moderne dhe funksionale, ku të gjitha drejtoritë komunale do të jenë të integruara në një vend të vetëm. Kjo jo vetëm që do të sigurojë kushte optimale për punonjësit, por edhe do të garantojë një qasje më të lehtë dhe më të shpejtë për qytetarët në marrjen e shërbimeve publike.

Qytetari nuk do të endet më nëpër zyrat e shpërndara për të marrë një dokument të vetëm. Objekt i ri do të thotë jo vetëm kushte të denja pune për stafin, por edhe respekt ndaj qytetarit dhe kohës së tij. Centralizim i shërbimeve, digjitalizim i proceseve dhe hapësira që reflekton një qeverisje të përgjegjshme.

3. Zyra për Menaxhimin e Projekteve

Do të themelojmë një Zyrë të veçantë për Menaxhimin e Projekteve në kuadër të komunës, e cila do të merret ekskluzivisht me përgatitjen, koordinimin dhe implementimin e projekteve kapitale dhe të donatorëve. Kjo zyrë do të jetë përgjegjëse për planifikim afatgjatë, sigurimin e fondeve dhe monitorimin në kohë reale të çdo ndërhyrjeje infrastrukturore, duke rritur transparencën dhe efikasitetin në menaxhimin e parasë publike.

Intervenime të tjera me rëndësi për komunën tonë

- Digjitalizimi i arkivës dhe procedurave të brendshme
- Do të rrisim kapacitetet profesionale të stafit përmes trajnimeve të rregullta, duke mundësuar përshtatjen me zhvillimet teknologjike dhe kërkesat bashkëkohore të shërbimeve publike.
- Do të garantojmë që çdo rekrutim të bëhet në mënyrë të hapur, transparente dhe në bazë të meritës, duke i dhënë fund praktikave të punësimit partiak dhe duke ndërtuar një administratë profesionale.
- Do të përmirësojmë kushtet e punës për të gjithë nëpunësit komunalë përmes pajisjeve të reja teknologjike, riorganizimit të zyrave dhe ofrimit të një ambienti të shëndetshëm dhe produktiv pune.
- Do të funksionalizojmë Zyrën e Gjendjes Civile në Duhël, duke garantuar ofrimin e shërbimeve themelore për banorët e kësaj zone pa pasur nevojë për udhëtime të panevojshme në qytet.

2.4 Mjedisi

për një komunë të pastër dhe të gjelbër

Vizioni ynë

Të ndërtojmë një komunë të pastër, të qëndrueshme dhe të vetëdijshme, ku ndarja në burim, riciklimi dhe trajtimi i duhur i mbeturinave bëhen pjesë e përditshmërisë qytetare, dhe ku secili kontribuon në ruajtjen e natyrës për gjeneratat që vijnë.

Për realizimin e këtij vizioni, do të investohen rreth 1 milion euro në edukimin dhe vetëdijesimin publik, ndarjen në burim, riciklimin, menaxhimin e landfillit, trajtimin e deponive ilegale dhe mbulimin e kostove për mbetjet me volum të madh. Ky angazhim nuk është vetëm për mjedisin sot, por për cilësinë e jetës në të ardhmen.

Çfarë na shqetëson?

Menaxhimi i mbeturinave në Suharekë vazhdon të jetë një ndër sfidat më të mëdha mjedisore. Në mungesë të ndarjes në burim, riciklimi mbetet pothuajse i pamundur, duke bërë që të gjitha mbeturinat të përfundojnë në deponi, pa asnjë proces filtrimi apo shfrytëzimi të tyre. Landfilli ekzistues ndodhet në një gjendje të degraduar, pa menaxhim të qëndrueshëm dhe me pasoja të drejtpërdrejta në mjedis.

Situata rëndohet më tej me qindra deponi ilegale, që kanë pushtuar si hapësirat publike, ashtu edhe zonat rurale. Ato janë dëshmi e mungesës së infrastrukturës bazike për ndarjen e mbeturinave në burim, e cila mungon thuajse tërësisht në fshatra dhe në shumë lagje urbane. Ndërkohë, bizneset lokale të riciklimit janë të lëna pas dore, të pambështetura dhe pa ndonjë rol të qartë në ekonominë e gjelbër.

Për më tepër, qytetarët kanë mungesë informacioni për mundësitë që ofron riciklimi, ndarjen në burim, apo sanksionet që parashihen për ndotësit. Mungesa e vetëdijes, e infrastrukturës dhe e mbështetjes institucionale po prodhon një krizë mjedisore të heshtur, që kërkon veprim urgjent dhe të qëndrueshëm.

Çfarë do të bëjmë ndryshe?

- Ndarja në burim e mbeturinave – 600 kontejnerë sipas vetive fizike
- Zhvillimi i sistemit të riciklimit
- Pyllëzimi i pyjeve të dëmtuara përmes donacioneve mjedisore evropiane

Prioritetet

1. Ndarja në burim e mbeturinave dhe mbrojtja e lumenjve

Do të ndërmarrim një aksion të gjerë për pastrimin e lumenjve dhe eliminimin e 32 deponive ilegale të identifikuara në territorin e komunës, duke vendosur kamera mbikëqyrëse dhe duke aplikuar gjoba për ndotësit. Paralelisht, do të zbatojmë ndarjen në burim të mbeturinave përmes vendosjes së 600 kontejnerëve të diferencuar për plastikë, letër, metal dhe mbetje organike në të gjitha lagjet urbane e rurale, si dhe ndërtimit të 12 pikave të qëndrueshme për ndarje selektive. Për të garantuar funksionimin e këtij sistemi, do të investojmë edhe në një kamion të specializuar për transport të mbeturinave të riciklueshme.

2. Zhvillimi i sistemit të riciklimit

Do të realizojmë marrëveshje me kompani të riciklimit, ngritje të pikave për dorëzim të tekstit dhe elektropajisjeve të vjetra, si dhe do të përkrahim financiarisht bizneset vendore që merren me riciklim. Kjo do të gjenerojë ekonomi qarkulluese dhe vende pune të reja.

3. Pyllezim i pyjeve te demtuara nga donacione te shumta mjedisore evropiane

Do të identifikojmë dhe rehabilitojmë zonat e pyjeve të dëmtuara përmes projekteve të financuara nga fondet dhe donacionet mjedisore evropiane. Ky proces do të shërbejë si hap i rëndësishëm për rimëkëmbjen ekologjike, përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe forcimin e rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike në territorin e Suharekës.

Intervenime të tjera me rëndësi

- Rekultivimi i landfillit ekzistues -mbulim me argjilë dhe gjelbërim, kthim në hapësirë publike. (Po ashtu, kemi menduar që të bëjme edhe deponi transfer ne fshatrat e mdhaja, me pas ti bartim tek deponia qendrore që do të caktohet ne vijim).
- Shërbim i rregullt për mbeturina me volum të madh -çdo muaj, me pika të përkohshme në çdo fshat. (ku do të behet perms njoftimit ne rrjetet sociale),
- Aplikacion mobil për qytetarët -informim për oraret e mbledhjes, pika të riciklimit dhe edukim. (Si dhe hapat tjere te rendesishem ne kete fushe).
- Transparencë dhe përfitime të prekshme -çdo lagje do të dijë sa ka kursyer komuna falë riciklimit. (duke bere statistika per secilen shtepi),
- Partneritete të forta me MASHTI, EcoRegjionin, ndermarrjen komunale locale dhe donatorë ndërkombëtarë.
- Monitorim dhe raportim mujor -për çdo hap që ndërmarrim.

2.5 Emergjencat

gatishmëri për çdo rrezik

Vizioni ynë

Një komunë e sigurt, me kapacitete funksionale për të parandaluar dhe përballuar çdo rrezik natyror apo human. Ne synojmë ndërtimin e një sistemi modern emergjencash, të gatshëm për reagim të shpejtë dhe efektiv në çdo situatë.

Për realizimin e këtij vizioni, do të investohen rreth 1.4 milionë euro në vazhdimin e ndërtimit të objektit të ri për zjarrfikësit, krijimin e 4 pikave në njësi lokale të zjarrfikësve, vendosjen e sistemit të alarmit dhe paralajmërimit publik, zhvillimin e infrastrukturës për reagim emergjent dhe aplikimin në grante ndërkombëtare për krijimin e strehimoreve në raste fatkeqësish natyrore apo humanitare.

Çfarë na shqetëson?

Vitet e fundit, Suhareka është përballur me një rritje të ndjeshme të zjarreve në tokat bujqësore dhe përmytjeve pas reshjeve intensive. Mungesa e infrastrukturës bazike për menaxhim të emergjencave, si stacioni i zjarrfikësve apo sistemi i alarmit, ka bërë që situata të përkeqësohet edhe më shumë.

Për fat të keq, çdo zjarr apo përmbytje është shndërruar në moment promovimi për "kryetarin e çizmeve", ndërkohë që vetë qeverisja e tij është një ndër shkaktarët kryesorë për mungesën e investimeve parandaluese dhe reagimin e vonuar në raste të tilla.

Çfarë do të bëjmë ndryshe?

- Vazhdimi i ndërtimit të objektit të zjarrfikësve
- Vendosja e sistemit të alarmit dhe paralajmërimit publik
- Planifikimi i infrastrukturës për reagim emergjent
- Projekte për grante evropiane për ndërtimin e strehimoreve në raste fatkeqësish

Prioritetet kryesore

1. Vazhdimi i ndërtimit të objektit të zjarrfikësve

Ndërtimi i objektit modern të njësisë së zjarrfikësve në Zonën Industriale, me qasje për reagim të shpejtë në qytet dhe në zonat rurale. Ky objekt do të përmbajë hapësira për automjetet, pajisjet, pushimoret dhe sallën e komandës.

2. Vendosja e sistemit të alarmit dhe paralajmërimit publik

Do të vendosim sistem paralajmërimi nëpër pika të rëndësishme të komunës për informimin në kohë reale të qytetarëve gjatë emergjencave, si zjarre, vërshime apo rreziqe të tjera natyrore.

3. Planifikim i infrastrukturës në funksion të reagimit emergjent

Do të ristrukturojmë dhe fuqizojmë sektorin e emergjencave brenda komunës, duke krijuar një njësi profesionale me përgjegjësi të qarta dhe reagim të shpejtë në rast rreziku. Ky sektor do të ketë staf të trajnuar, logjistikë efikase dhe koordinim të drejtpërdrejtë me institucionet e tjera lokale dhe qendrore.

Intervenime të tjera me rëndësi për komunën tonë

- Krijimi i njësie vullnetare për emergjenca nëpër fshatra, me trajnime bazike dhe përfshirje aktive të komunitetit në menaxhimin e rrezikut.
- Pajisje moderne për zjarrfikësit, duke përfshirë automjete të reja, uniforma të standardit të lartë dhe pajisje për ndërhyrje në raste të zjarreve në ndërtesa të larta.
- Investime në rrjetin e furnizimit me ujë dhe vendosja e hidranteve në lagjet urbane, zonat industriale dhe në afërsi të institucioneve publike.
- Planifikim i infrastrukturës në funksion të reagimit emergjent, përfshirë qasje më të lehtë për automjete zjarrfikëse dhe evakuim të shpejtë të banorëve në raste të fatkeqësive.

2.6 Mërgata

ata për ne, ne shërbim të tyre

Vizioni ynë

Ne besojmë në një marrëdhënie të gjallë dhe reciproke mes mërgatës dhe vendlindjes. Mërgata nuk duhet trajtuar vetëm si burim remitencash, por si partnere aktive në zhvillimin ekonomik, kulturor e institucional të Komunës së Suharekës. Do të krijojmë ura reale bashkëpunimi që tejkalojnë distancën fizike dhe forcojnë ndjesinë e përkatësisë.

Çfarë na shqetëson?

Sot, mërgata e Suharekës është e larguar fizikisht nga komuna, fatmirësisht ende e lidhur emocionalisht me të. Mungesa e politikave të qëndrueshme për përfshirjen e tyre ka prodhuar një boshllëk të madh në raportin me vendlindjen. Marrëveshjet e binjakëzimeve janë harruar, shkëmbimet kulturore janë pothuajse të inekzistente dhe pjesëmarrja e diasporës në proceset vendimmarrëse lokale është zero. Në vend të afrimit, kemi distancim gjithnjë e më të madh.

Çfarë do të bëjmë ndryshe?

- Krijimi i “Parkut të Mërgatës”
- Përfshirja e mërgatës në vendimmarrje përmes platformave digjitale
- Fuqizimi i zyrës për mërgatë

Prioritetet kryesore

Parku i mërgimtarit

- Parku përfaqëson një Suharekë të zvogëluar në shkallë të vogël. Parku do të ketë gjithsejtë 3.61 hektarë hapësirë me përmbajtje në shërbim të qytetarëve, me koncept pushimi, rekreacioni. Do të ketë përmbajtje të kombinuar, mbi 45% i pyllëzuar, me funksione përcjellëse të nevojshme për parkun. Brenda parkut do të lejohet vetëm lëvizja e mjeteve jo motorike, këmbësorëve dhe emergjencat. Në vende të caktuara të zvogëluara në shkallë proporcionale, parku përfaqësohet nga simbolikat lokale si: Zona e Dëshmorëve, Kulla e Ramë Blacës, Zona e Kastërrcit, etj.



#ASHE

- Do të rivitalizojmë marrëveshjet e binjakëzimit që Komuna e Suharekës ka pasur me qytetet tjera në Evropë dhe do të nisim krijimin e marrëveshjeve të reja.
- Do të organizojmë Kampin Veror të Mërgatës, ku nxënës dhe studentë nga diaspora do të takohen me moshatarët e tyre në Suharekë për aktivitete kulturore, edukative dhe shkëmbim përvojash.

Fuqizimi i Zyrës për Mërgatë

Forcimi i lidhjes mes komunës dhe qytetarëve tanë që jetojnë jashtë vendit. Kjo zyrë do të shërbejë si pikë kontakti për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mërgatën, duke ofruar mbështetje institucionale, informim të qartë dhe shërbime të dedikuara për nevojat e tyre.

Nëpërmjet fuqizimit të saj, synohet krijimi i mekanizmave për përfshirjen aktive të mërgimtarëve në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të komunës.

Zhvillimi i projekteve të përbashkëta, lehtësimi i investimeve dhe ruajtja e identitetit kulturor janë vetëm disa nga prioritetet që do të udhëhiqen nga kjo zyrë, duke e bërë mërgatën një **partner të barabartë** dhe të domosdoshëm në proceset zhvillimore të komunës.

Ekonomia

e planifikuar, e shpërndarë, e qëndrueshme

Një ekonomi komunale që funksionon nuk është vetëm çështje numrash, por një mjet për drejtësi sociale dhe mirëqenie të ndarë. Në Suharekë, për vite me radhë, ekonomia është menaxhuar pa vizion dhe buxheti publik është shpërdoruar për interesa afatshkurtra elektorale, duke lënë pas një territor të pabarabartë në zhvillim, me zona të braktisura dhe me mundësi të pakta për qytetarët. Ne besojmë se ekonomia fillon me buxhetin dhe përfundon me ndikimin që ai ka në jetën e përditshme të secilit qytetar. Prandaj, angazhohemi për menaxhim të drejtë dhe transparent të parasë publike, me fokus në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të barabartë.

Në këtë kuadër, planifikimi hapësinor do të marrë trajtimin që i takon. Nuk do të lejojmë më që ndërtimi i qytetit të bëhet me shkëlma, pa plan dhe pa respekt për hapësirat publike. Një qytet i organizuar është bazë për ekonomi të qëndrueshme, jetë të shëndetshme dhe komunitete të fuqizuara. Do ta kthejmë Suharekën në një hapësirë për njerëz, jo për beton e vetura.

Bujqësia do të trajtohet si një sektor strategjik, jo si skemë për mbijetesë. Fermerët tanë nuk do të shihen si zë votash, por si prodhues të vërtetë dhe kontribuues në ekonominë lokale. Mbështetja për bujqësinë do të fokusohet në prodhimtari, modernizim dhe treg të qëndrueshëm, jo në subvencione të shpërndara pa kriter.

Turizmi do të dalë nga harta e potencialit të harruar dhe do të bëhet pjesë reale e zhvillimit ekonomik të komunës. Me pasuri natyrore, historike dhe kulturore që i ka zili çdo rajon, Suhareka ka çdo arsye për të qenë destinacion mikpritës për vizitorë dhe burim i të ardhurave për komunitetin lokal. Ne do ta lidhim trashëgiminë me të ardhmen përmes shërbimeve moderne dhe përvojave unike.

Dhe mbi të gjitha, mërgata jonë do të trajtohet si partnere zhvillimi, jo thjesht si dërguese remitencash. Do ta përmbysim logjikën e vjetër të përfitimit nga larg dhe do të krijojmë mekanizma konkretë për t'i sjellë ata më afër vendlindjes në ekonomi, në kulturë dhe në vendimarrje.

Përmes kësaj shtylle që përfshin ekonominë, buxhetin dhe financat, planifikimin hapësinor, bujqësinë dhe mërgatën, synojmë të ndërtojmë një model zhvillimi që është i drejtë, i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Gjatë katër viteve të ardhshme, do të investohen rreth 6.5 milionë euro për të ndërtuar një ekonomi vendore që mbështetet në buxhet publik të menaxhuar me përgjegjësi, planifikim të mirëfilltë të hapësirës, sektor bujqësor të gjallë dhe mërgatë të përfshirë si partnere e barabartë në zhvillim.

3.1 Ekonomia, Buxheti dhe Financat

Nga paratë publike te ndryshimi konkret

Vizioni ynë

Të zhvillojmë një komunë me ekonomi dinamike, me financa publike të menaxhuara me efikasitet dhe transparencë, që krijon mundësi të barabarta dhe rrit cilësinë e jetës për qytetarët e Suharekës.

Për realizimin e këtij vizioni, do të investohen rreth 500 mijë euro, të cilat do të orientohen në digjitalizimin e administratës dhe pagesave, rritjen e zonave të tatimit në pronë, krijimin e fondit për bizneset e vogla dhe start-up-et, si dhe ngritjen e platformave për transparencë dhe llogaridhënie. Financimi i këtyre ndërhyrjeve do të sigurohet përmes kombinimit të buxhetit komunal dhe granteve nga partnerë ndërkombëtarë si GIZ, UNDP, BE, OSBE, MAPL dhe MBPZHR.

Çfarë na shqetëson?

Për tetë vite rresht, financat publike të Suharekës janë përdorur si instrument klientelist, jo si mjet zhvillimi. Buxheti është copëtuar në projekte pa vizion, me shpenzime të shpërndara për qëllime elektorale dhe jo për nevojat reale të komunitetit. Në vend të një zhvillimi strategjik dhe të barabartë, kemi pasur një ekonomi të centralizuar vetëm në zona të caktuara, duke lënë periferinë të fundoset në harresë.

Tatimi në pronë, që do të duhej të ishte burim i qëndrueshëm për investime, është keqmenaxhuar –vetëm 29.98% e potencialit të tij është mbledhur në vitin 2024. Kjo tregon për një administratë të pafuqishme, sistem të prapambetur dhe mungesë vullneti për ta trajtuar qytetarin si kontribuues, e jo si votë sezonale.

Për bizneset e vogla dhe të mesme, nuk ka ekzistuar asnjë program real zhvillimi. Asnjë grant, asnjë lehtësim konkret, asnjë platformë bashkëpunimi. Klima e të bërit biznes është mbytur nga burokracia, mungesa e mbështetjes dhe ambienti jostimulues për investime.

Në anën tjetër, auditorët publikë vazhdojnë të evidentojnë keqpërdorime dhe zbatim të pjesshëm të rekomandimeve –vetëm 54.54% janë adresuar. Raportet nuk janë më dokumente për reflektim, por alibi për status quo.

Këshillat qytetare janë reduktuar në formalitete. Dëgjimet publike mbahen për sy e faqe, ndërsa qytetarët nuk e shohin veten në asnjë vendim të madh të komunës. Transparenca nuk ekziston – qytetari nuk ka qasje në asnjë informacion financiar në kohë reale.

Çfarë do të bëjmë ndryshe?

- Ndryshimi i rregullores për taksat komunale
- Krijimi i Fondit për Zhvillim Ekonomik për mikro-biznese dhe start-up
- Hapja e Zyrës për Investime nga Diaspora

Prioritetet kryesore

1. Ndryshimi i rregullores për taksat komunale

Do ta ndryshojmë rregulloren aktuale për taksat komunale duke e bërë më të drejtë dhe më të lehtë për qytetarët dhe bizneset. Bizneset mikro dhe të vogla do të lirohen nga taksa komunale për aktivitet, me qëllim që të stimulojmë hapjen e bizneseve të reja dhe të gjallërojmë ekonominë lokale. Kjo masë do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e punësimit dhe do të krijojë një mjedis më të favorshëm për ndërmarrësit.

2. Fondi për Zhvillim Ekonomik për mikro-biznese dhe start-up

Do të krijojmë një Fond për Zhvillim Ekonomik në vlerë prej 800,000 euro për periudhën katërvjeçare, i dedikuar mbështetjes së mikro-bizneseve dhe start-up-eve lokale. Ky fond do të ofrojë grante, trajnime dhe mentorim për ndërmarrësit e rinj, duke synuar krijimin e vendeve të reja të punës dhe zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme dhe inovative në komunën tonë.

3. Zyra për investime nga diaspora

Do të themelojmë Zyrën për Investime nga Diaspora si një pikë të vetme kontakti dhe shërbimi për të gjithë bashkatdhetarët që dëshirojnë të investojnë në vendlindje. Zyra do të ofrojë asistencë përmes informimit, procedurave të shpejta administrative dhe qasjes në projektet lokale të zhvillimit ekonomik, duke kthyer kapitalin dhe përvojën e diasporës në zhvillim konkret për komunën.

4. Platforma për transparencë buxhetore

Për të rritur llogaridhënien dhe përfshirjen qytetare, do të krijojmë një platformë digjitale për transparencën buxhetore të komunës. Përmes kësaj platforme qytetarët do të kenë qasje në të gjitha kontratat, investimet publike dhe shpenzimet komunale në kohë reale, duke e bërë komunën tonë shembull të qeverisjes së hapur dhe të përgjegjshme.

Intervenime të tjera me rëndësi për komunën tonë

- Vendosja e sistemit të monitorimit të projekteve kapitale në kohë reale për të garantuar zbatim cilësor dhe afatshkurtër të investimeve.
- Trajnime për stafin komunal në fushën e menaxhimit të financave publike dhe planifikimit buxhetor për të rritur efikasitetin institucional.
- Themelimi i Bordit Qytetar për Mbikëqyrje të Buxhetit -një mekanizëm i pavarur për vëzhgimin e shpenzimeve publike.
- Zgjerimi i bazës tatimore për të siguruar të hyra të qëndrueshme për komunën dhe luftimi aktiv i informalitetit ekonomik.

3.2 Planifikimi hapësinor

qytet i planifikuar, jetë e organizuar

Vizioni ynë

Të ndërtojmë një Suharekë të planifikuar me mendje dhe me zemër –një qytet funksional e të gjelbër, ku hapësirat publike u kthehen njerëzve, zhvillimi ekonomik mbështetet në infrastrukturë të drejtë dhe gjithëpërfshirëse, dhe komuniteti është bashkëkrijues në çdo hap të transformimit urban e rural.

Për realizimin e këtij vizioni, do të investohen rreth 2.8 milionë euro në zhvillimin e zonave të reja të banimit dhe agrozonw industriale, funksionalizimin urban të qendrës së qytetit për këmbësorë, ndërtimin e infrastrukturës për biçikleta, ndriçim solar e mobilim ekologjik, si dhe në krijimin e hapësirave publike të gjelbra, qendrave komunitare dhe rrjetit infrastrukturor për zonat industriale e bujqësore. Në zemër të këtij transformimi do të jetë bashkëkrijimi me komunitetin, përdorimi efikas i tokës publike dhe standardet më të mira të urbanizmit të qëndrueshëm.

Çfarë na shqetëson?

Gjendja aktuale e hapësirave publike në Suharekë lë për të dëshiruar: parqet, sheshet dhe trotuaret janë të pakta, të paorganizuara dhe pa funksion shoqërues për jetën urbane. Ato nuk krijojnë hapësirë për komunitet, por mbesin të mbyllura në beton e asfalt pa hijeshi, pa gjelbërim dhe pa qasje për fëmijët, të moshuarit apo personat me nevoja të veçanta.

Kaosi urban është rezultat i moszbatimit të planifikimit ndërtimet pa leje, mosmbikëqyrja e objekteve me leje, dhe mosmenaxhimi dhe mungesa e parkingjeve kanë krijuar lagje të ngulfatura, ku ndërtesat rriten pa asnjë standard funksional ose estetik. Qendra e qytetit nuk është më hapësirë për njerëzit, por një arterie e mbipopulluar nga veturat, ndërsa trotuaret janë të pushtuara nga kafenetë dhe automjetet.

Pronat publike nuk menaxhohen mirë -shumë prej tyre mbesin të pashfrytëzuara, ose keqpërdoren për interesa të ngushta private. Zonat industriale dhe ekonomike janë gjysmë të përfunduara, me infrastrukturë të mangët që i largon investitorët, jo i afron. Ndërkohë, zona rekreative e Dellocit -që mund të ishte destinacion për zhvillim rural dhe turistik -mbetet një potencial i lënë në harresë.

Çfarë do të bëjmë ndryshe?

- “Suhareka e Gjelbër” – qytet funksional dhe ekologjik
- Funksionalizimi i Agrozonës Industriale në Samadrexhë
- Zona Ekonomike në Duhël – zhvillim i kontrolluar dhe i planifikuar

Prioritetet kryesore

“Suhareka e Gjelbër” – qytet funksional dhe ekologjik

Do të themelohet fondi “Suhareka e Gjelbër”, ku do të përfshihen subvencionet për kulme të gjelbra në objekte publike dhe privat, instalimi i fasadave të gjelbra urbane si dhe do të krijohet manuali teknik për aplikimin e fasadave me gjelbrim vertikal. Në kuadër të fondit “Suhareka e Gjelbër” do të mbahen trajnime për qytetarët dhe do të mbështeten për të zbatuar masa të efijencës së energjisë njëkohësisht përmes fondit do të synohen të sigurohen burime financiare në fushën e efijencës së energjisë.

Funksionalizimi i Agrozonës Industriale - Samadrexhë

Agrozona në Samadrexhë do të bëhet qendra e zhvillimit agropërpunues në komunën tonë. Do të investojmë në infrastrukturën e munguar (rrugë, ujësjellës, kanalizim, ndriçim, energji, internet) dhe do të hartojmë rregulla të qarta për dhënien në shfrytëzim të tokës publike. Bizneset që merren me bujqësi, agropërpunim ose bashkëpunim me fermerët lokalë do të kenë prioritet. Kjo zonë do të gjallërojë ekonominë vendore dhe do të krijojë mundësi për bashkëpunim me kooperativa e prodhues individualë.

Zona Ekonomike Duhel -zhvillim i kontrolluar dhe me plan

Në Duhel do të zhvillohet një zonë e re ekonomike me infrastrukturë moderne dhe ndarje funksionale sipas nevojave të prodhimit, përpunimit dhe tregtisë. Do të hartojmë Planin Rregullues të Hollësishëm në bashkëpunim të ngushtë me bizneset dhe do të sigurojmë që ndërtimet të ndjekin zhvillimin e infrastrukturës, duke parandaluar kaosin ndërtimor. Investitorët do të përzgjidhen me kriterë të qarta dhe marrëveshje afatgjata, në mënyrë që kjo zonë të shërbejë si model zhvillimi për komunën.

Intervenime të tjera me rëndësi për komunën tonë

- Lagjja e re e banimit në Samadrexhë: banim i përzier me tokë për vetëprodhim bujqësor
- Hartimi i Planit Rregullues për Zonën Industriale në Shirokë, duke shqyrtuar me kujdes sfidat dhe problematikat aktuale të bizneseve dhe mundësitë të inkorporimit të zgjidhjeve në plan
- Hartim i Planit Rregullues të Hollësishëm zona Shirokë - Prizren sipas kriterëve zhvillimore ekonomike
- Zhvillimi i Dellocit si zonë rekreative dhe turistike për turizëm të qëndrueshëm
- Rishqyrtimi HZK dhe inicimi i PZHK 2030 - 2038
- Ruajtja, destinimi dhe funksionalizimi i objekteve ekzistuese të vjetra për të mbrojtur dhe përforcuar memorien kolektive

3.3 Bujqësia

nga toka te tregu

Vizioni ynë

Bujqësia në Komunën e Suharekës do të marrë trajtimin që e meriton si një ndër shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe punësimit në katër vitet e ardhshme. Programi ynë synon një transformim të plotë të sektorit bujqësor përmes modernizimit të mënyrës së prodhimit, ngritjes së vetëdijes prodhuese dhe shfrytëzimit të potencialit natyror dhe njerëzor që ofron territori ynë.

Për realizimin e këtij vizioni, do të investohen rreth 3.1 milionë euro në mbështetje për pemëtarinë dhe perimtarinë, ndërtimin e serave, zhvillimin e sektorit të vreshtarisë, blegtorisë, shpezëtarisë dhe bletarisë, si dhe për përmirësimin e infrastrukturës së ujitjes dhe fuqizimin e prodhuesve të fidanëve dhe bimëve dekorative.

Çfarë na shqetëson?

Pavarësisht potencialit të jashtëzakonshëm që ka bujqësia në Komunën e Suharekës, ky sektor është lënë pas dore për vite me radhë. Mungesa e infrastrukturës moderne, mbështetja minimale për fermerët e vegjël, shpërndarja jokonsistente e subvencioneve dhe mungesa e aksesit të qëndrueshëm në tregje dhe në ujë për ujitje kanë frenuar zhvillimin e bujqësisë lokale.

Për më tepër, premtimet e bëra nga udhëheqësit aktualë nuk janë realizuar: fermerët nuk janë vizituar në terren siç ishte zotuar, nuk është respektuar premtimi për të mbështetur çdo serrë me minimumin prej 5 arësh, dhe buxheti për bujqësinë nuk është rritur as për së afërmi me premtimin për trefishim.

Kjo ka krijuar zhgënjim të madh te prodhuesit vendorë dhe ka ulur besimin në institucionet lokale.

Çfarë do të bëjmë ndryshe?

- Ndërtimi i mini-digave dhe infrastrukturës ujitëse për tokat bujqësore
- Krijimi i fondit emergjent për mbrojtjen e kulturave bujqësore
- 3.1 milionë euro investime komunale në bujqësi dhe synohen projekte për 8 milionë euro nga fondet e BE-së

Prioritetet kryesore

1. Ndërtimi i mini-digave dhe infrastrukturës ujitëse për tokat bujqësore

Për të përballuar ndikimet e mungesës së reshjeve dhe thatësisë, do të ndërtojmë mini-diga dhe kanale ujitëse për të gjitha zonat bujqësore që sot vuajnë nga mungesa e ujit për vaditje. Këto investime do të rrisin rendimentin dhe do të mbrojnë kulturat nga dëmtimet klimatike.

2. Ngritja e prodhimit në të gjitha degët e bujqësisë

Do të krijojmë kushte për rritje të qëndrueshme të prodhimit bujqësor në sektorët më të rëndësishëm të komunës sonë: vreshtari, pemëtari, pemë të imta (dredhëza, mjedër, aronia), perimtari, lavërtari, blegtori, bletari, shpezëtari dhe dhëntari. Ky zhvillim do të bazohet në investime direkte dhe mbështetje të pakushtëzuar për fermerët.

3. Rritja e subvencioneve për kulturat bazë bujqësore

Do të rrisim subvencionet komunale për kulturat strategjike bujqësore si gruri, misri, patatja, fasulja dhe kultura të tjera që kanë potencial të lartë për vetëprodhim. Subvencionimi do të jetë në formën e mbulimit të inputeve bujqësore: fara, pleh kimik dhe mbrojtje biologjike.

Investime të drejtpërdrejta:

- **Mekanizëm bujqësor:**

- o 100,000 € në vit për shpërndarje të pajisjeve moderne (800 njësi në 4 vite)

- **Sektori i ujitjes:**

- o 100,000 € në vit për hapje pusish, kanale ujitëse dhe mini-diga

- o Ndihmë e veçantë për zonat me mungesë të ujit

- **Blegtori, dhëntari dhe shpezëtari:**

- o 50 lopë qumështore në vit

- o Ndërtim i 20 shtallave moderne

- o 600,000 € investim total

- o Punësim shtesë për të paktën 10 persona

- o 200,000 € për bletari/shpezëtari dhe 40 punëtorë të rinj

- **Lavërtaria:**

- o Mbështetje me fara dhe plehra për grurë, misër dhe kultura të tjera strategjike

- o Investim: 200,000 € në vit

- **Shërbime këshillimore për fermerët**

- o Rritje e kapaciteteve të Zyrës Këshillimore

- o Automjet për vizita në terren dhe organizim të shkëmbimit të përvojave brenda dhe jashtë Kosovës

- **Fondi emergjent për mbrojtjen e kulturave bujqësore**

- o Krijimi i një fondi për përballimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe për blerjen e rrjetave, pesticideve dhe mjeteve të tjera mbrojtëse



#ASHE

Pse Ardian Shala? Pse në këtë kohë?

Suhareka do të transformohet përmes një vizioni të ri, të ndërtuar mbi tri shtylla që nuk lëkunden - arsim i fortë, shërbime publike të dinjitetshme dhe një ekonomi e bazuar në zhvillim.

Ardian Shala është personi i duhur në kohën e duhur. Ai është siguria e vetme që Suhareka të bëhet qendër rajonale zhvillimi dhe shembull se si qeveriset ndershëm, pastër dhe në shërbim të qytetarit. Ky nuk është një program për t'u lexuar - është një plan konkret për të ndryshuar përditshmërinë e secilit banor të kësaj komune.

Arsimi nuk do të mbetet më në harresë. Me këtë program, shkollat do të bëhen hapësira që edukojnë dhe fuqizojnë, jo vetëm vend ku mbyllet ora. Fëmijët do të mësojnë në kushte të denja, me mësimdhënie moderne, mësim tërëditor dhe mbështetje të plotë për mësimdhënësit. Prindërit do ta dinë se investimi më i madh për të ardhmen e fëmijës së tyre po ndodh në lagjen dhe fshatin e tyre.



#ASHE

Shërbimet publike do të rikthejnë dinjitetin e qytetarit. Shëndetësia do të jetë më e afërt, administrata më e shpejtë dhe infrastruktura më funksionale. Askush nuk do të presë me orë të tëra për një dokument, një vizitë mjekësore apo një rrugë të asfaltuar. Çdo banor, në çdo cep të komunës, do të ndjejë dorën e shtetit në krah, jo në xhep.

Ekonomia nuk do të jetë privilegj i të lidhurve me pushtetin. Buxheti do të menaxhohet me drejtësi, bujqësia do të mbështetet për të prodhuar, jo për të mbijetuar, dhe të rinjtë do të kenë hapësirë për të qëndruar, krijuar dhe zhvilluar. Mërgata nuk do të trajtohet më si dërguese remitencash, por si bashkë-partnere në zhvillim. Dhe mbi të gjitha: Suhareka do të ketë një vizion 10-vjeçar për ta kthyer veten në qendër turistike rajonale – me shtigje, bujtina, promovim dhe ekonomi të re që krijon vende pune në mikpritje dhe kulturë.

Ardian Shala nuk premtan, ai garanton. Me përvojë të dëshmuar si mjek, integritet të pakontestueshëm si qytetar dhe vendosmëri për të qeverisur me duar të pastra, ai është personifikimi i politikës që nuk shet fjalë, por jep rezultate. Me Ardian Shalën në krye, Suhareka do të ketë jo vetëm një kryetar, por një udhëheqës që e sheh qytetarin si bashkëudhëtar, jo si votues sezonal.



**Ardian
Shala**



Suhareka
PËRTEJ